Kuvendi i Komunës Klinë
Debat me Publikun
01Nr 06-31921 */26*
Klinë, dt: 06.10 */26*

PROCESVERBAL

Nga Debati me Publikun, mbajtur më 04.09.2026, me fillim në orën 10:00, në sallën e Kuvendit të Komunës së Klinës.

Mbledhjen e hapi kryesuesi i Kuvendit, z. Enver Berisha, i cili përshëndeti kryetarin e komunës, prof. dr. Zenun Elezaj, nënkryetarin e komunës, z. Fadil Gashi, drejtorët e drejtorive komunale dhe të gjithë të pranishmit.

RENDI I DITËS

Draft- Buxheti i Komunës së Klinës për vitin 2027

Enver Berisha, kryesues: Mirëserdhët në këtë takim për projektbuxhetin e vitit 2027. Fillimisht janë bërë dëgjime buxhetore nëpër bashkësi lokale, por besoj ju jeni të vetëdijshëm se ky draftbuxhet është debatuar edhe në fillim të qershorit, është debatuar për Kornizën Afatmesme Buxhetore, por, ashtu siç e do Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Ligji për Buxhet dhe për Financa, ne jemi të obliguar që edhe projektbuxhetin e vitit 2027 ta debatojmë bashkërisht dhe në fund ta bëjmë një parapërgatitje për draftin për seancën e Asamblesë Komunale, që do të jetë në fund të këtij muaji. Unë fillimisht, në emër timin, e përshëndes për prezencë kryetarin e komunës, prof. dr. Zenun Elezaj, nënkryetarin e komunës, z. Fadil Gashi, drejtorin e Financave, z. Faruk Smajli, asamblistët dhe gjithë ju, qytetarë, që jeni të pranishëm këtu. Një pjesë, kush ka pasur mundësi me përcjellë këtë debat nëpër lokalitete të caktuara, ndoshta e kanë parë se çka ka paraparë ekzekutivi për këtë draft-buxhet për vitin 2027 dhe, po ashtu, edhe nga materialet që janë të shpërndara nga faqja e komunës. Unë besoj se fillimisht ia japim fjalën drejtorit të Financave, z. Faruk Smajli, i cili e ka bajt barrën e këtij draftbuxheti, bashkë me kryetarin dhe ekzekutivin, dhe mandej ju mund të kyçeni në debat me propozime, me ato që ju i vlerësoni që janë në interes të qytetarëve. Projektbuxheti i vitit është një prej pikave më të rëndësishme që Kuvendi Komunal, bashkë me ekzekutivin, i aprovojnë për vitin e ardhshëm, kështu që kontributi i gjithsecilit është i mirëseardhur dhe po shpresoj që në ato projekt-ide që edhe ju i shfaqni, ta ndihmojmë edhe

ekzekutivin për një draft të kompletuar, serioz dhe që është në interes të gjithë qytetarëve të komunës sonë, pa dallim, dhe me qenë një draft-buxhet i kompletuar, me kusht që ne tani, me implementimin e tij, t'i realizojmë ato kërkesa që qytetarët e Klinës i kanë para vetes. Drejtor, fjala është e juaja.

Drejtori Faruk Smajli: Faleminderit, kryesues. I nderuar kryetar, nënkryetar, të nderuar qytetarë të Komunës së Klinës, sot para jush prezantojmë, pra, draftbuxhetin e Komunës së Klinës për vitin 2027, ku, pas pranimit të qarkores së dytë buxhetore, e cila i përcakton kufijtë përfundimtarë brenda të cilëve Komuna e Klinës duhet të përgatisë buxhetin e saj, pra për vitin 2027. Buxheti i përgjithshëm i Komunës së Klinës është prej 16 milionë e 845 mijë e 517 euro. Gjatë përgatitjes së draftbuxhetit janë shqyrtuar kërkesat e drejtorive komunale, kërkesat e paraqitura gjatë dëgjimeve të para buxhetore, kërkesat e qytetarëve, si dhe projektet kapitale, të cilat janë vlerësuar dhe janë prioritare për vitin 2027. Pra, pjesa më e madhe e këtij buxheti është e destinuar për paga dhe mëditje, ku prej tyre 10 milionë e 132 mijë e 134 euro janë për kategorinë e pagave dhe mëditjeve, pastaj për mallra dhe shërbime 1 milion e 600 mijë euro, për shpenzime komunale 370 mijë euro, subvencione dhe transfere në vlerë prej 800 mijë euro, investime kapitale në vlerë prej 3 milionë e 893 mijë e 883 euro. Në krahasim me kufijtë e përcaktuar të Kornizës së Parë Buxhetore, fondi për investime kapitale na është zvogëluar në vlerën prej 308 mijë euro. Këto mjete na i kanë orientuar te kategoria e pagave dhe mëditjeve, si rezultat i përcaktimit të kuptimeve të qarkores së dytë buxhetore. Pra, kemi një kufizim në hapësirën financiare për investime kapitale. Për këtë arsye, gjatë hartimit të draftbuxhetit jemi detyruar që projektet kapitale t'i renditim sipas prioriteteve dhe nevojave urgjente të komunës. Pikërisht për këtë arsye, këto dëgjime publike dhe ky debat me qytetarë janë shumë të rëndësishme dhe duam që së bashku me qytetarë t'i përcaktojmë se cilat janë projektet më urgjente dhe cilat duhet të kenë përparësi në kuadër të këtyre mjeteve të disponueshme. Ju faleminderit, jemi këtu për propozimet e juaja dhe çdo kërkesë që paraqitni.

Enver Berisha, kryesues: Faleminderit, drejtor. Atëherë, të nderuar të pranishëm, po hap debatin dhe, para se ta merrni fjalën, secili prej jush të prezantohet me emër dhe mbiemër, për shkak të procesverbalit që duhet të evidentohet. Urdhëroni, fjala është e juaja. Urdhëro, z. Tunë Deda e ka fjalën.

Tunë Dedaj: Përshëndetje për kryetarin e komunës, z. Zenun Elezaj, përshëndetje për ju, kryesues, për nënkryetarin e komunës, z. Fadil Gashi dhe për të gjithë të pranishmit. Unë e përcjella me vëmendje, por për investimet kapitale prej 300 mijë euro, unë nuk e di ku janë bazuar, ku janë bërë, çka kanë bërë me atë sublim, sepse aty drejtpërdrejt atakohen qytetarët e Komunës së Klinës, atakohen taksapaguesit, dmth. mbeten rrugët pa u shtruar, një kanalizim, një ujësjellës, që s'është i mirë, po dua që vitin e ardhshëm të parashihet, se pari, në Deiq. Kërkoj që të bëhet trotuari prej kishës deri te lagjja e Zeqirëve, një trotuar që është me ndriçim e me krejt, kërkoj që të bëhet trotuari prej Klinës deri në Videjë, mundësisht deri te shkolla fillore, edhe asfaltimi i rrugës është krejt i prishur në Leskoc, dhe lagjja Prenaj në Gjurgjevik të Madh, t'ju çohet asfalti deri te shtëpitë e vjetra. Faleminderit shumë, kryetar. Dua të falënderoj shumë për krejt punët që i ke bërë gjatë këtyre viteve. E di që buxhetin na i kanë marrë arsimtarët e krejt, por me gjet ndonjë bashkëpunim me qeverinë dhe me gjet zgjidhje. Faleminderit shumë.

Enver Berisha, kryesues: Faleminderit, Tune Deda. Dikush tjetër?

Arif Berisha, fshati Gjurgjevik: Përshëndes kryetarin dhe nënkryetarin. Desha të pyes për rrugën kryesore të fshatit, e cila ka ngarkesë të madhe prej gurthyesve aty. A është në projekt ajo rrugë me u shtruar apo jo?

Enver Berisha, kryesues: Faleminderit. Dikush tjetër? Urdhëro, z. Kryeziu.

Ragip Kryeziu: Ju përshëndes gjithë ju të pranishëm që jeni në sallë, kryetarin, nënkryetarin dhe të gjithë të pranishmit. Ky debat me të vërtetë është një kënaqësi e madhe. Unë propozoj që çdo send që është i prishur, që është punuar përpara, kam qejf me i arnuar ato gjëra. Dmth është ura, se na e kanë prishur trotuarin aty edhe krejt fëmijët çka vijnë në shkollë ecin nëpër rrugë. E dyta, kjo rruga është duke na penguar shumë, se jo me thyer e me prit gjashtë-shtatë muaji apo një vit, se mos është shumë e rëndë. E treta, trotuaret se janë rregulluar në të dy anët e rrugëve, lirisht mund të them se ai njeri që ka pasur shtëpi aty, edhe kanë vënë zallë aty për me bërë rrugë kaluese se s'ka mundësi për t 'kaluar. Po thonë këto kocka në qytet me u heq, unë e shprehi mendimin tim se është gjynah, se kurrkund vend më të mirë nuk kemi se këtë pjesë, se është e rrafshuar me trotuar e me krejt.

Enver Berisha, kryesues: Dikush tjetër? Urdhëro, prezantohu.

Banor i fshatit Jashanicë (nuk prezantohet me emër): Ju përshëndes të gjithëve. Ne çka jetojmë në këtë fshat, na i ka rregulluar me të gjitha, me ujë, me ujësjellës, me çka lypet aty, e falënderoj shumë kryetarin Zenunin, se ka punuar mirë. Kryetar më të mirë s'mund të gjejmë, faleminderit.

Enver Berisha, kryesues: Faleminderit, dikush tjetër? Urdhëro, Isa Ibishi.

Isa Ibishi: Përshëndetje për ju, kryesues, përshëndetje për kryetarin, nënkryetarin, për të gjithë të pranishmit. Unë, me thënë të drejtën, duke e përcjell fillimin e debatit rreth hartimit të buxhetit, si dokumenti më i rëndësishëm i vitit, e shoh një neglizhencë te qytetarët tanë që nuk po janë shumë aktivë rreth interesave dhe investimeve në lokalitetet e veta. Komuna jonë i ka formuar këshillat e fshatrave që janë të përfaqësuar në mënyrë dinjitoze dhe kryetarët e atyre fshatrave që, në një formë, edhe janë t 'paguar, që interesat e atij lokaliteti me i prezantuar te kryetari, te ekzekutivi edhe me e këqyr çka mund të realizohet prej atyre kërkesave. E kam përcjell edhe kryetari kur i ka sjell në tubim të gjithë kryetarët e këshillave, nuk shoh njëfarë angazhimi të tyre. Është mirë, në qoftë se nuk angazhohen, me ia lëshuar rrugën dikujt tjetër, që ato kërkesat e tyre me i përfaqësuar në hartim të buxhetit, se është në interes edhe të tyre, edhe i ekzekutivit, edhe i Klinës etj. Për shembull, unë e kam parë te Rasim Mërmullaku, prezantimi i 5-6 kërkesave që i kam unë që i ka bërë, është për kënaqësi, edhe i këqyr çka është prioritet, vjen te ekzekutivi, e këqyr e prezanton te drejtori, te kryetari, çka është. Janë 5 prioritete që janë të domosdoshme me u investuar, e këqyr për sivjet në harmoni me kryetarin se çka mund të investohet. Ky është një mekanizëm që e ka mundësuar edhe ligji, që e lehtëson punën deri te përfshirja e gjitha projekteve që kanë nevojë qytetarët. Ju faleminderit.

Enver Berisha, kryesues: Faleminderit, Isa Ibishi. Fjalën e ka kryetari i Komunës, z. Zenun Elezaj.

Prof. dr. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës së Klinës: Faleminderit, kryesues. Përshëndetje për të gjithë ju të pranishmit. Bazuar në diskutimet që u bënë, realisht, procedura e hartimit të buxhetit që ka ardhur sot në debat publik, unë e kam themeluar një komision i cili do të hartojë raport për Kuvendin Komunal, dhe të gjitha kërkesat që u bënë sot, por edhe në të gjitha takimet, kanë me u trajtuar nga ana e komisionit dhe me i dhanë propozimet se në cilën kohë mund të realizohen ato kërkesa të qytetarëve. Të gjitha ato vijnë bashkangjitur, draftbuxhetit edhe raporti i komisionit, të cilin do ta shqyrtojë Kuvendi dhe sigurisht do ta aprovojë me ndryshime apo kështu. Tash, prej të gjitha kërkesave, disa janë pjesë e trajtimit të komisionit edhe të Kuvendit më vonë, por unë vetëm Arifit po i përgjigjem që e bëri një kërkesë direkte, lidhur me rrugën e Gjurgjevikut të Madh. Jam i vetëdijshëm që, sikur çdoherë që është ndërprerë, besa edhe këtë vit, kur po ka fluks dhe ngarkesë të madhe në komunikacion, shumica e qytetarëve e kanë mësuar rrugën e Ujmirit që prej Caravikut, po edhe në Rixhevë dhe Gjurgjevik t'madh. Për Gjurgjevikun e Madh nuk është projekti në buxhet, por rruga ka hyrë në performancë, edhe bashkë me kryetarin e fshatit edhe me një grup që e kemi diskutuar, jemi pajtuar që ta ndërtojmë një trotuar këtë vit dhe do të fillojë tani, d.m.th. është në procedurë, nga shkolla deri tek shtëpitë e fundit, me pretendim që me zgjat deri te hekurudha dhe rruga Klinë-Ujëmirë. Ndërsa kërkesa për rindërtimin e rrugës jemi duke e negociuar një projekt bashkë me Ministrinë e Infrastrukturës, kemi bërë kërkesë, por të shohim edhe çështja e kompletimit e formimit të qeverisë së re, deri aty ka stagnuar. Është një projekt më i madh, po për ndërtimin e rrugëve në Komunën e Klinës, që e kap rrugën Jelloc-Resnik, rrugën e Gjurgjevikut të Madh, rrugën e Deiqit, shtresë të re, d.m.th. Zajm-Deiq, rrugën e Qeskovës, rrugën e Këpuzit, d.m.th. nga Dollova-Këpuz, rrugën Ranoc-Leskoc komplet edhe rruga Ranoc-Shtupel. D.m.th. është edhe ajo e planifikuar dhe pritet të zhvillohen rreth 1 milion e gjysmë euro, dhe të gjitha këto rrugë do të arnohen, d.m.th. gropat ku janë dhe pastaj do t'i shtrohet një shtresë e re, sikur që është bërë rruga e Sferkës, Shtupelit dhe Zllakuqanit, në Krushevë pak më herët është bërë. Po shpresoj që vitin e ardhshëm, sepse këtë vit në qoftë se fillojnë procedurat e prokurimit, eventualisht firmosjes së kontratës, për vitin e ardhshëm, mirëpo nuk është në mundësitë buxhetore të komunës. Është edhe rruga e Caravikut që është rrugë në nivelin e mirëmbajtjes qendrore, një vlerë rreth 1 milion e gjysmë euro, të gjitha këto do të kryhen. Faleminderit shumë.

Enver Berisha, kryesues: Faleminderit, kryetar. Dikush tjetër? Urdhëro, Tunë Deda.

Tunë Deda: Drejtor, kam informacion se viti fillor ka filluar e ditarët s'kanë qenë të gatshëm, ku është problemi?

Enver Berisha, kryesues: Urdhëro, drejtor.

Qemajl Sejdija, drejtor i DKA-së: Faleminderit, kryesues. I nderuar kryetar, të pranishëm, po është e vërtetë që Ministria e Arsimit është vonuar me marrë vendimin me përzgjedhë shtëpinë botuese që i ka dhënë ato dokumentacione. Kemi një informatë prej Ministrisë së Arsimit që të hënën dhe të martën do të fillojnë me i furnizuar shkollat me ditarë. Shpresoj të na dalin të saktë. Faleminderit shumë.

Enver Berisha, kryesues: Faleminderit. Urdhëro, kryetari e ka fjalën edhe njëherë.

Prof. dr. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës së Klinës: Dua të ndërlidhem me z. Ragipin. Kjo rrugë që po flitet nga e hyra në qytet deri te magjistralja Pejë-Prishtinë është e kontraktuar nga ana e Ministrisë, dhe normal edhe ne jemi të pakënaqur që nuk është finalizuar, por jemi në kontakt. Jemi duke i bërë kërkesat e vazhdueshme edhe me rregullimin e shtresës së re të asaj rruge. Besoj që do të harmonizohen të gjitha ato mospërputhje të trotuareve, d.m.th. ka mbetur që kjo fazë finale me i rregulluar gjitha ato. Po m 'duket e ke një kërkesë te ura e hekurudhës te lumi Klina. Këtë vit nuk kemi pasur asnjë kontratë të firmosur me kompanitë për rregullimin e trotuarit. Për momentin tani jemi në procedura me fondin e performancës që e kemi përfituar, që jemi një prej komunave me transparencë buxhetore më të mirë prej tri komunave. E kemi shpallur një procedurë dhe po besoj që deri brenda muajit do ta kemi kontratën dhe sigurisht edhe atë kërkesë që e ke bërë, sepse edhe unë e kam marrë direkt prej teje si kërkesë, dhe do ta finalizojmë.

Enver Berisha, kryesues: Faleminderit, kryetar. Dikush tjetër? Nëse jo, atëherë ju falënderoj për kohën që e keni ndarë të jeni sot në këtë debat. Shihemi në debatet tjera.

Procesmbajtësja
Monika Palushi Gojani

REPUBLIKA E KOSOVËS · REPUBLIC OF KOSOVO · KOMUNA E KLINËS · MUNICIPALITY OF KLINA · OPSTINA ②

KRYESUESI
z. Enver Berisha